



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

AD/GJTHFR.nr.9/2023

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese A.K., avokat nga Prishtina, me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 29 shtator 2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj S.K., e paraqitur nga pala ankuese A.K., avokat nga Prishtina, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj përkatësisht autoriteti kompetent i kësaj gjykate - kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, *(në tekstin e mëtejme autoriteti kompetent)*, më 30 gusht 2023 ka pranuar ankesën e palës ankuese A.K., avokat nga Prishtina (tutje ankuesi), me pretendimin për shkelje disiplinore nga neni 5 par.2.2 lidhur me par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ndaj gjyqtarit S.K.. Me datë 31.08.2023, ankuesi përmes e-mailit i ka dërguar autoritetit kompetent edhe kopjen e vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.14.08.2023, me të cilën kjo gjykatë e ka hedhur si jo lëndore Kërkesën për

Mbrojtje të Ligjshmërisë të ushtruar ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së paraburgimit si dhe ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

Ankuesi në ankesën e tij me shkrim, ka njoftuar se ndaj të pandehurit I.V. është duke u zhvilluar procedurë penale pran Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda e evidentuar me numër SMIL si 2023:146869, në drejtim të dyshimit për veprat penale fajde nga neni 331 par.3 lidhur me par.1 si dhe shmangie nga tatimi nga neni 307 par.1 të KPRK-së, dhe se datë 05.07.2023, gjykata ka nxjerrë aktvendimin 2023:146869 me anë të së cilit të pandehurit I.V. i ka caktuar masën e paraburgimit prej 1 (një) muaj, duke filluar nga data 03.07.2023 deri me datë 02.08.2023.Me datë 06.07.2023, në cilësi të mbrojtjes së të pandehurit, duke vepruar konform afatit të përcaktuar ligjor, kemi ushtruar ankesë ndaj aktvendimit të mësipërm të kësaj gjykate. Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga mbrojtja, me datë 27.07.2023 ka nxjerrë aktvendimin me numër PN1.DKR.nr.802/2023 me anë të së cilit kishte refuzuar ankesën e mbrojtjes së të pandehurit. Aktvendimin në fjalë në cilësi të mbrojtjes e kemi pranuar me datë 02.08.2023 apo pikërisht ditën e skadimit të afatit të masës së paraburgimit të përcaktuar me aktvendimin e atakuar. Me këtë rast, duke konsideruar si shkelje të afateve të parapara për trajtimin e ankesës ndaj caktimit të masës së paraburgimit, siç do ti trajtojmë në tekstin vijues, janë ndërmarrë nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, në këtë drejtim po me datë 02.08.2023 kemi parashtruar ankesë kundrejt veprimeve të gjykatës në fjalë. Me datë 24.08.2023 nga Gjykata e Apelit të Kosovës-Kryetari i Gjykatës z.Valon Totaj kemi pranuar aktvendimin ADGJA.nr.08/2023 me anë të së cilës refuzohet si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga ana jonë. Në arsyetimin e vendimit në fjalë, Kryetari i Gjykatës së Apelit jep sqarime përkatëse duke shpjeguar se lënda në fjalë (duke iu referuar ankesës kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit) në Gjykatën e Apelit përmes sistemit SMIL është pranuar dhe printuar me datë 25.07.2023. Në këtë mënyrë lë të nënkuptohet se ankesa e mbrojtjes së të pandehurit nga ana e Gjykatës së Apelit është pranuar hiç më pak se 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë pas dorëzimit të sajë.

Andaj duke u bazuar në të cekurat më lartë, parashtrojmë se shkeljet e afateve ligjore të parapara lidhur me trajtimin e ankesës kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit, janë ndërmarrë nga ana e Gjykatës Themelore në Ferizaj-Gjyqtarit të Procedurës Paraprake S.K., për arsye të cilat do ti elaborojmë në vijim.

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN1.DKR.nr.802/2023 është i pasafatshëm si pasojë e dërgimit me vonesë të ankesës së mbrojtjes së të pandehurit I.V. kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit nga ana e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake S.K.. Ligjvënësi në dispozitën e nenit 186 të Kodit të Procedurës ka rregulluar përmbajtjen e aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit dhe së bashku me të edhe procedurën e ankimimit ndaj sajë. Në këtë mënyrë në paragrafin 3 të kësaj dispozite parashihet se: Secila palë mundë të paraqes ankesë brenda dyzet e tetë (48) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mundë tja paraqes gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga paraqitja e përgjigjes, apo skadimi i afatit për parashtrimin e përgjigjes në Gjykatën e Apelit.

Për të argumentuar se aktvendimi i Gjykatës së Apelit i atakuar nëpërmjet këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik është i pasafatshëm dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm, ankuesi ka paraqitur edhe kronologjinë e veprimeve të ndërmarra nga palët në procedurën e gjerë më tanishme. Aktvendimi për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit I.V. nga gjykata e shkallës së parë është nxjerrë me datë 05.07.2023. Ankesa ndaj këtij aktvendimi është ushtruar pas 24 orëve, gjegjësisht me datë 06.07.2023. Ankesa e mbrojtjes e ushtruar me datë 06.07.2023, është pranuar nga Gjykata e shkallës së dytë, nëpërmjet Gjykatës së shkallës së parë me datë 25.07.2023 apo 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë me vonesë. Prokuroria e Apelit e Kosovës me datë 27.07.2023 apo 21 ditë më vonë ka ushtruar përgjigje ndaj ankesës së mbrojtjes së të pandehurit I.V.. Gjykata e Apelit të Kosovës me datë 27.07.2023 nxjerrë aktvendimin me të cilin refuzon ankesën e ushtruar nga mbrojtja, të cilin veprim e ndërmerr 21 ditë nga dorëzimi i ankesës së mbrojtjes. Mbrojtja e z.V., aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës e pranon me datë 02.08.2023 apo pikërisht ditën e skadimit të aktvendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit, të cilin e kishte ankimuar nëpërmjet ankesës në fjalë.

Ankuesi ka theksuar Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, gjegjësisht gjyqtari i procedurës paraprake S.K. ka qenë i obliguar që duke marr parasysh që bëhet fjalë për procedurë penale lidhur me caktimin e masës së paraburgimit dhe natyrën emergjente të sajë, të veproj me nguti të posaçme. Obligimi për të vepruar në formë të tillë rrjedh nga dispozita e nenit 182 par.2 të Kodit të Procedurës, në të cilin parashihet si vijon:

Kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që marrin pjesë në procedurën penale dhe organet që ofrojnë ndihmën juridike detyrohen të veprojnë me nguti të posaçme. Duke shpërfillur në tërësi të drejtat e të pandehurit I.V. në procedurën në fjalë dhe faktin se i njëjti i nënshtrohet një mase e cila konsiston në privimin e lirisë së tij, si njëra nga të drejtat themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventa ndërkombëtare, gjyqtari në fjalë ia përcjell ankesën e mbrojtjes Gjykatës së Shkallës së Dytë 19 (nëntëmbëdhjetë) ditë me vonesë, duke sjellë kështu për pasojë shkeljen e afateve të parapara me dispozitën e nenit 182 par.2 dhe 186 par.3 të Kodit të Procedurës Penale.

Duke qenë se masa e paraburgimit ndaj të pandehurit kishte për të skaduar me datë 02.08.2023 dhe në cilësi të mbrojtjes së tij me datë 31.07.2023 kishim pranuar kërkesën e re të Prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj tij edhe për 2 (dy) muaj të tjerë, në anën tjetër ishim sjellë në një situatë në të cilën përderisa ishte arritur afati për paraqitjen e kësaj kërkesë të prokurorisë dhe potencialisht trajtimit të mundësisë për vazhdimin e masës së paraburgimit, ne ende nuk kishim pranuar vendimin e gjykatës së shkallës së dytë në raport me ankesën e ushtruar paraprakisht, duke mos qenë në dijeni nëse aktvendimi fillestar për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tij ishte anuluar apo jo.

Se ankesa e mbrojtjes në këtë rast është dërguar me vonesë nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake dëshmohet edhe me faktin se me rastin e aktvendimit të nxjerrë nga ana e të njëjtit gjyqtar për vazhdimin e masës së paraburgimit i datës 02.08.2023 nuk kishte pasur vonesa të njëjta.

Në këtë rast Gjykata e Apelit e Kosovës kishte vepruar në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore në drejtim të trajtimit të ankesës së mbrojtjes ndaj vazhdimin të masës së paraburgimit kundër të pandehurit I.V. Pra kjo dëshmon qartë se vonesat në rastin e parë, gjegjësisht në rastin e trajtimit të ankesës së mbrojtjes kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit kanë qenë të qëllimshme ose nga neglizhenca serioze e gjyqtarit të procedurës paraprake S.K. në kohën dhe mënyrën siç e kemi trajtuar më sipër.

Në këtë formë i pandehuri është privuar nga e drejta e tij për ushtrimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik të paraparë në nenin 432 par.4 të KPP-së, duke qenë se tashmë aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë vetëm se kishte skaduar.

Si përfundim parashtrojmë që veprimet e tilla të këtij gjyqtari paraqesin diskriminim dhe trajtim jo të drejtë të z.V. në procedurën e cila zhvillohet ndaj tij, ashtu që si të tilla konsistojnë në shkelje sipas dispozitës së nenit 5 par.2,2 lidhur me par.1 nënpar.1,2 dhe 1,3 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore.

Gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje S.K., në deklaratën e tij me shkrim të datës 18.09.2023 lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se pretendimet e mbrojtësit të autorizuar të të pandehurit I.V., av.A.K. se kam bërë shkelje disiplinore nga neni 5 par.2,2 lidhur me par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (06/L-057) janë krejtësisht ët pabazuara për arsye se:

Gjykata Themelore në Ferizaj me datë 01.03.2023 me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj ka lëshuar urdhëresë për kontrollin e shtëpive dhe objekteve tjera përcjellëse për 21 (njëzet e një) të pandehur e ku në mesin e të cilëve ka qenë i përfshirë edhe i pandehuri I.V. Me datë 03.03.2023 Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj 15 (pesëmbëdhjetë) të pandehurve dhe lënda në gjykatë ka marrë numër unik në SMIL si 2023:056749 ndërsa numër të dosjes 2023:056815, ndërsa në këtë kërkesë nuk ka qenë i përfshirë i pandehuri I.V., pasi i njëjti nga koha e bastisjes ka qenë në arrati, ndërsa me datë 04.07.2023 Prokuroria Themelore pasi është arrestuar i pandehuri I.V. ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit e cila kërkesë ka numër unik të njëjtë pra 2023:056749 ndërsa ka marrë numër të dosjes 2023:146869.

Në vazhdim të deklaramit të tij gjyqtari ka deklaruar se çdo shkresë që pranohet në zyrën e pranimit në gjykatë duhet të identifikohet saktë në dosjen konkrete në SMIL. Në rastin konkret e njohur si rasti “Fajde”, shumica e shkresave shtesë është dashur të regjistrohen në sistemin smilnga dy ose tre herë për arsye të gabimeve të bashkëngjitjes së shkresave në dosjet e sakta në SMIL dhe e gjithë kjo mundë të vërehet në histori të dosjeve që ka lënda e rastit “Fajde” pasi shumë shkresa (ankesa ose ndonjë parashtrësë tjetër) janë të regjistruara nga disa herë deri sa është regjistruar në mënyrë të saktë dhe është dashur të përmirësohen disa herë meqë të njëjtat në dosje që është dashur të bashkëngjitet shkresa janë regjistruar gabimisht. Sa i përket dosjes me numër 2023:146869 në histori të lëndës vërehet se ankesa ndaj të pandehurit I.V., është pranuar fizikisht me datë 11.07.2023 por e njëjta nuk është regjistruar në mënyrë të rregullt nga zyrtarët e shkrimesores pranimit, me ç’rast nuk kemi pas mundësi ta bartim ankesën për në Gjykatë të Apelit.

Shkrimorja është njoftuar që regjistrimi i ankesës nuk është në rregull prandaj duhet të regjistrohet prapë sa më shpejtë të jetë e mundur në mënyrë që të bartet lënda në Gjykatën e Apelit. Me datë 25.07.2023 vërehet që e njëjta ankesë është regjistruar prapë dhe është përmirësuar gabimi i regjistrimit të parë, me ç'rast menjëherë pas përmirësimit të gabimit në po të njëjtën ditë pra me datë 25.07.2023 është bartur ankesa për Gjykatën e Apelit. Kjo dëshmon që bartja e ankesës nuk është vonuar fare dhe asnjë ditë, mirëpo ka pas problem me regjistrimin e sajë (ankesës) në sistemin SMIL dhe në pamundësi të bartjes në forma tjera, është dashur të pritët deri sa është rregulluar regjistrimi i sajë në sistem e pastaj të bartet në Gjykatën e Apelit. Gabime të njëjta për lëndën "Fajde" janë paraqitur pothuajse çdo ditë ku asnjë shkresë që ka ardhur nga zyra e pranimit nuk ka qenë e mundur të vendoset rreth tyre ose të trajtohet pa pas përmirësime në SMIL në regjistrim të mëparshëm. Për gabimet e shumta që po i bën administrata përkatësisht zyra e pranimit në gjykatë unë e kam përmendur edhe në mbledhjen e kolegjiut të gjyqtarëve, gjithashtu kanë qenë të njoftuar edhe zyrtarët e shkrimores, IT-ja dhe edhe zyrtarja e SMIL-it e ku të njëjtit gjithherë janë marrë me përmirësime të këtyre gabimeve.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit të rastit si dhe shkresave tjera që ka bashkangjitur pala ankuese, e po ashtu edhe shkresave që janë të vendosura në sistem SMIL ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit S.K., për shkak se:

Me lëndën e njohur si rasti "Fajde" e që evidentohet në gjykatë me numër unik në SMIL si: 2023:056749 është i ngarkuar gjyqtarit S.K., si gjyqtar i procedurës paraprake në Departamentin për Krime të Rënda dhe se i njëjti duke vendosur në kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj të datës 03.03.2023, me datë 04.03.2023 ka vendosur për kërkesën e kësaj Prokurorie ndaj 15 (pesëmbëdhjetë) të pandehurve, ndërsa i pandehuri I.V., nuk ka qenë i përfshirë në këtë kërkesë për shkak se ka qenë në arrati.

Gjithnjë sipas historikut të lëndës me numër unik 2023:056749, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit I.V., në gjykatë është parashtruar me datë 04.05.2023 dhe se gjyqtari i ngarkuar me këtë çështje me datë

05.07.2023 ka nxjerrë aktvendimin për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të njëjtit, aktvendim i cili u është dorëzuar palëve.

Mbrojtësi i të pandehurit, tani parashtruesi i ankesës disiplinore, në afatin ligjor ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit, ankesë kjo e cila sipas historikut të lëndës në SMIL, është pranuar në gjykatë fizikisht me datë 11.07.2023 dhe pas regjistrimit të sajë në sistemin SMIL, i është dorëzuar zyrës së gjyqtarit të çështjes për të ndërmarrë veprimet e nevojshme përmes sistemit SMIL-it për bartjen e sajë në Gjykatën e shkallës së dytë, mirëpo sipas deklaratës së gjyqtarit por edhe nga historiku i lëndës me numër unik 2023:056749 dhe numër të dosjes 2023:146869 vërtetohet se ankesa e mbrojtësit të të pandehurit, tani parashtrues i ankesës disiplinore, është pranuar në gjykatë me datë 11.07.2023 dhe është regjistruar në sistemin SMIL më pas i është dorëzuar zyrës së gjyqtarit të çështjes.

Në evidencën e sistemit SMIL, por edhe nga sqarimet që kam marr unë si autoritet Kompetent nga zyrtarët e SMIL-it, vërehet se me rastin e regjistrimit të kësaj ankese në SMIL është bërë një gabim teknik për çka më pas gjyqtari i çështjes nuk ka pas mundësi të bartë këtë ankesë në Gjykatën e shkallës së dytë për shkak të këtij gabimi teknik zyrtarja ligjore nga zyra e gjyqtarit ankesën në fjalë e ka dërguar prapë në zyrën e pranimit dhe në shkrimoren penale për të rregulluar problemin e regjistrimit të sajë, rregullim i cili është kryer me datë 25.07.2023 e që vërtetohet edhe nga deklaratimet me shkrim të zyrtares ligjore e cila punon në zyrën e gjyqtarit, referentit të pranimit, referentit të regjistrimit të lëndëve në sistem por edhe nga zyrtarja e SMIL-it pran kësaj gjykate dhe se me rastin e trajtimit-rregullimit të problemeve lidhur me regjistrimin e kësaj ankese, zyrtarët e administratës të përmendur më lartë gjegjësisht Zyrtarja Ligjore që punon në zyrën e gjyqtarit si dhe referenti i pranimit kanë bërë lëshime, gjegjësisht nuk e kanë kryer me kohë rregullimin e gabimit lidhur me regjistrimin e ankesës në sistem (nga data 11.07.2023 deri me datë 25.07.2023).

Autoriteti Kompetent, me rastin e trajtimit të ankesës së ankuesit lidhur me vonesat e trajtimit të ankesës së të pandehurit I.V., ndaj vendimit të caktimit të paraburgimit të datës 05.07.2023, ka marr veprime në drejtim të zbardhjes dhe sqarimit të kësaj suate dhe shkakun e kësaj vonese të bartjes së lëndës për në Gjykatën e Apelit. Ka marr deklaratat e zyrtarëve kompetent (zyrtares ligjore të angazhuar në zyrën e gjyqtarit, referentëve të shkrimores së pranimit

dhe atij të regjistrimi su dhe zyrtares së SMIL-it), dhe se nga të gjitha këto deklarata, është konstatuar se deri te vonesa e trajtimit të kësaj ankese dhe bartjen e lëndës për në Gjykatën e Apelit ka ardhur për shkak të regjistrimit në mënyrë jo të duhur në sistemin SMIL të ankesës së mbrojtësit të pandehurit, av.A.K., dhe si rezultat e këtij gabimi teknik nga zyra e regjistrimit, kjo ankesë fillimisht nuk ka mundur me kohë të bartet për në Gjykatën e Apelit, mirëpo duke pasur parasysh që kjo dosje është shumë voluminoze, me mbi njëzet të pandehur dhe disa procedura janë zhvilluar jo të gjitha përnjëherë por procedura në vazhdimësi varësisht nga hetimet e prokurorit të çështjes, pra është procedurë me shumë palë dhe shumë mbrojtës dhe kërkesa të shumta që vijnë nga palët por edhe mbrojtësit e tyre, siç janë vendimet për masat e sigurisë (paraburgimet, arrestet shtëpiake) por edhe masat tjera, dhe kjo lëndë në sistem ka një numër unik, mirëpo për shkak të këtij numri të madh të pandehurve në këtë procedurë dhe procedimit të tyre të gjitha përmes sistemit SMIL ndodh që edhe mund të vije edhe tek ndonjë gabim teknik tek përdoruesit e sistemit të SMIL-it, për çka edhe ka pasur këso gabime edhe atë jo vetëm në gjykatën tonë por në gjitha gjykatat, duke përkujtuar faktin se me vendim të KGJK-së, të gjitha ankesat për në Gjykatën e Apelit të Kosovës barten vetëm përmes sistemit SMIL (jo fizikisht), gabime të tilla edhe mundë të jenë evidente në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Autoriteti kompetent, me rastin e trajtimit të këtij rasti, grumbullimit të informatave, dhe analizimit të tyre ka konstatuar se Gjyqtari i çështjes nuk ka qenë fare i njoftuar lidhur problemet e paraqitura në këtë rast, pasi që me trajtimin e punëve teknike e administrative në zyrën e gjyqtarit merret zyrtari ligjor i zyrës së gjyqtarit, i cili nuk e ka njoftuar gjyqtarin e rastit, por as mbikëqyrësit tjerë të drejtpërdrejtë të tij se ka një gabim në sistemin SMIL gjatë procedimit të ankesës për në Gjykatën e Apelit.

Andaj, Për të gjitha këto lëshime të zyrtarëve të gjykatës të cilët janë marrë me këtë çështje, Gjykata përmes mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të zyrtarëve kompetentë ka ndër marrë veprime disiplinore në raport me lëshimet në kryerjen apo moskryerjen e punëve dhe detyrave të tyre me kohë ashtu siç edhe përcaktohet me ligj.

Për më tepër Autoriteti kompetent konstaton se pretendimi i parashtruesit të ankesës, se veprimet e gjyqtarit S.K. në rastin e trajtimit të ankesës së mbrojtjes kundër aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit kanë qenë të qëllimshme ose nga neglizhenca serioze, nuk qëndrojnë dhe të njëjtat janë të pabazuara, ngase nga ajo që është konstatuar më lartë, nga deklaratat e zyrtarëve të administratës është vërtetuar se vonesa në fjalë nuk është shkaktuar për shkak neglizhencës së gjyqtarit mirëpo për shkak të zyrtarëve të administratës ndaj të cilëve janë

marrë masa dhe veprime disiplinore konform procedurave, andaj nuk mund të themi se gjyqtari ka bërë shkelje disiplinore në drejtim të diskriminimit dhe trajtimit jo të drejtë të paraparë në nenin 5 paragrafi 2.2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit për Përgjegjësinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, apo se vonesa në trajtimin e ankesës nga ana e gjyqtarit ka qenë e qëllimshme ose nga neglizhenca serioze siç ka pretenduar parashtruesi i ankesës disiplinore në ankesën e tij.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ankesën me kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore nga ana e gjyqtarit, andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
AD/GJTHFR.9/2023, datë 29 shtator 2023**

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Avokat A.K. - Parashtrues i ankesës

S.K. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës